



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada – Government - Zyra e Kryeministrit – Ured Premijera – Office of the Prime Minister



AGJENCIA E STATISTIKAVE TE KOSOVES
AGENCIJA ZA STATISTIKE KOSOVA
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS



REGJISTRIMI I BUJQËSISË
POPIS POLJOPRIVREDE
AGRICULTURE CENSUS

REGJISTRIMI I BUJQËSISË – POPIS POLJOPRIVREDE - AGRICULTURE CENSUS

Duke u bazuar në dispozitat e Ligjit nr. 04/L-253 për Regjistrimin e Bujqësisë dhe Ligjit Nr.04/L-36 për Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës, Regjistrimi i Bujqësisë do të realizohet sipas metodës tradicionale (derë më derë). Regjistrimi do të bëhet në të gjitha ekonomitë familjare në vendbanimet rurale dhe në vendbanimet urbane në ato ekonomi familjare të cilat gjatë Regjistrimit të popullsisë 2011 janë deklaruar se janë ekonomi familjare bujqësore. Andaj Agjencia e Statistikave të Kosovës shpallë:

K O N K U R S

Për realizimin e Regjistrimit të Bujqësisë 2014, për pozitën:

Titulli: **REGJISTRUES**

Numri i referencës : **RB-01**

Numri i pozitave sipas Komunave të Republikës së Kosovës:

Komuna e Kaçanik: Aktiv 53 pozita (53 shqiptar) . **Rezerve 4 pozita** (4 shqiptar)

Detyrat dhe përgjegjësit :

1. Të merr pjesë në trajnim.
2. Të kryej regjistrimin.
3. Të lexojë me kujdes manualin me udhëzime dhe ti përmbahet atij.
4. Të krijoj komunikim të mirë me kontrollorin e tij.
5. Të garantoj konfidencialitetin
6. Të raportoj kontrollorit në baza ditore për mbulueshmërinë e regjistrimit
7. Të ruajë materialet e regjistrimit
8. Të respektoj orarin e punës
9. Të promovojë Regjistrimin e Bujqësisë

Kriteret:

Për të qenë i kualifikuar për punën e Regjistruesit në Regjistrimin e Bujqësisë 2014, kandidati duhet të:

Përmbush kriteret OBLIGATIVE:

1. Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës
2. Të jetë i të paktën 18 vjeç (person i rritur por jo më i vjetër se 65 vjeç)
3. Të ketë së paku shkollën e mesme,
4. Mos të jetë i dënuar dhe mos të jetë nën hetime
5. Të njohë terrenin dhe të jetojë në territorin ku do të bëjë Regjistrimin e Bujqësisë
6. Të kenë telefon celular (aktiv)
7. Të kenë dorëshkrim të lexueshëm.

Kriteret shitesë që kandidatëve ju japin PËRPARËSI :

1. Niveli më i lartë i shkollimit (fakulteti, shkolla e lartë, student absolvent, student dhe shkolla e mesme në drejtimet e Bujqësisë-Veterinarisë dhe Pylltarisë)
2. Përvoja e punës në arsim
3. Pjesëmarrja në Regjistrimin e Popullsisë 2011
4. Pjesëmarrje në Anketën Ekonomike Familjare Bujqësore
5. Pjesëmarrja në Regjistrim Testues të Bujqësisë 2012
6. Përvojë pune në ASK në tri vitet e fundit
7. Të papunësuar.

Kohëzgjatja e punës

Punësimi do të zgjasë 30 ditë (një muaj) duke filluar nga duke filluar nga 26.10.2014 deri më 26.11.2014.

Pagesa për REGJISTRUES

Pagesa mbulon trajnimin, punën gjatë regjistrimit, numërimin e materialit deri tek dorëzimi i tyre, raporteve si dhe shpenzimet e transportit dhe telefonit. Regjistruesi rezervë në rast të aktivizimit do të paguhet si aktiv. Pagesa për punën e kryer bëhet konform buxhetit të RB

Procedurat e Aplikimit

Kandidatet e interesuar duhet të aplikojnë në zyrën komunale për Regjistrimin e Bujqësisë 2014

Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit obligativ, që janë: Dokument identifikimi, vërtetim nga Gjykata që personi nuk është nën hetime; vërtetime kualifikimi, çertifikata dhe vërtetimet për përvojën e punës së kërkuar për vendin e punës për të cilin konkurroni. Referencat tjera mund t'i bashkëngjiten aplikacionit si shtesë dokumentacionit të kërkuar.

Aplikacionet pranohen nga data 08.09.2014 deri më datën 22.09.2014 në ora 15:00 në kopje fizike (printuar) pranë Komisioneve komunale të regjistrimit të bujqësisë në të gjitha Komunitetet e Kosovës.

Informata e përgjithshme

Kërkesat e dërguara pas afatit (datës) së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara do të refuzohen.

Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të thirren për testim dhe intervistë .

Kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do t'i nënshtrohen testimit me shkrim dhe intervistës. Kandidatët do të njoftohen për datën dhe kohën e testimit dhe intervistave.

Për informata më të hollësishme, mund të kontaktoni Zyrat komunale për Regjistrimin e Bujqësisë ndërsa përmes faqes së internetit të ASK-së <http://ask.rks-gov.net> (Departamenti i Bujqësisë – vegëza për Regjistrimin e Bujqësisë ku gjendet materiali -Udhëzuesi dhe Pyetësori për përgatitjen e testit).

Komunitetet dhe Agjencia e Statistikave të Kosovës ofrojnë mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet të komunës.

Sipas metodologjisë së regjistrimit të bujqësisë, Regjistruesi duhet të jenë nga vendbanimi dhe zona e regjistrimit ku ata jetojnë, ku 85% të pozitive të kërkuara do të pranohen nga vendet rurale. Realizimi i projektit të Regjistrimit Bujqësisë kërkon kandidatë të cilët janë komunikativ, të gatshëm për punë ekipore të cilët aplikojnë në pozitën e kërkuar.